Kronikë

Dyshohet se strehonte të shumëkërkuarin Talo Çela, arrestohet 60-vjeçari në Elbasan! Në banesën e tij u gjetën mijëra paund e euro dhe arsenal armësh

Një oeracion i Policisë së Elbasanit ka vënë në pranga Aqif Bezatin, 60 vjeç, i dyshohet se strehonte të shumëkërkuarin Talo Çela në një prej pronave të tij.

Talo Çela dhe Aqif Bezati i arrestuar

Redaksia
14 Tetor, 22:40 | **Përditesimi: 15 Tetor, 13:08**

Një oeracion i Policisë së Elbasanit ka vënë në pranga Aqif Bezatin, 60 vjeç, i dyshohet se strehonte të shumëkërkuarin Talo Çela në një prej pronave të tij. Në momentin që është ndërhyrë në një banesë në fshatin Deshiran, Belsh, nuk u gjet asnjë gjurmë e Celës, por vetëm sasi e madhe parash, arsenal armësh dhe kanabis.

Policia kishte marrë informacione në rrugë operative se dihej vendndodhja e Talo Celës, por edhe ky rast për të cuar pas hekurave të shumëkërkuarin dështoi.

LEXO EDHE:
Incidenti i mësuesit në Gramsh, pronari i lokalit: Na ra pa ndjenja në banak, i dhamë ndihmën e parë

Në njoftimin e policisë së Elbasanit theksohej se në banesën e Bezatit janë gjetur dhe sekuestruar: një armë zjarri kallashnikov, një pistoletë, 6 granata dore, 3280 fishekë pistoletë dhe kallashnikovi, 5 krehra fishekësh, 3.6 kilogramë kanabis, 75 bimë të thata të dyshuara opium, 3.760.000 lekë të rinj, 5000 paund dhe 8950 euro, të cilat dyshohet se i ka përfituar nga veprimtaria kriminale në fushën e narkotikëve dhe të trafikimit të armëve.

Në pranga ka rënë dhe një person tjetër i identifikuar si Veli Deliu, i cili ka lidhje shoqërore me Bezatin. Gjatë kontrollit në banesën e tij u gjetën dhe sekuestruan një armë gjahu dhe 55 fishekë arme gjahu, të cilat Veli Deliu i mbante pa leje.

Talo Çela, i shumëkërkuari i policisë doli edhe në dëshminë e të penduarit të drejtësisë Nuredin Dumani në dosjen ***'Plumbi i Artë'***. Ai zbuloi se ka kryer krimet më të shumta me Çelën dhe dy ortakët njiheshin me pseudonimet Lala dhe Bubi, pjesë e të njëjtit grup kriminal, por që shoqëria mes tyre mori fund pas grabitjes në aeroportin e Rinasit, për ndarjen e 4.3 milionë euro.

A.M./Shqiptarja.com

TAG: veli deliu | belsh | talo cela | aqif bezati | Elbasan | operacioni golden bullet

Komento

Komente

End Duro: 14/10/2022 23:09

Strehoeni o fare e keqe se dy qe e strehuan ne Durres i hoqi qafe.Nuk paska te mbaruar rraca e keqe ne kete vend

Përgjigju

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Kërkesa për rritjen e pagës, si e vlerësoni vendimin e pedagogëve për të bojkotuar nisjen e viti të ri akademik?

Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

Lajme të tjera

Në pranga 70-vjeçari në Elbasan, rezulton i dehur në timon
14 Tetor, 13:05



Drogë, arsenal armësh, miliona lekë, euro e paund, kapen 2 persona në Cërrik! U sekuestrohen kallashnikovë e armë gjahu
14 Tetor, 09:06

Aksident në Mengel të Elbasanit, 'Benzi' përplas punëtorin e pastrimit të kontejnerëve! Dërgohet në spital, ende s'dihet gjendja e tij (VIDEO)
13 Tetor, 21:44

Incident në Gramsh, mësuesi 37-vjeçar rrëshqet gjatë orës së mësimit dhe dëmtohet në kokë! Transportohet te Trauma me helikopter ushtarak (VIDEO)
13 Tetor, 19:31



'Më jep 3000 euro ose i tregova gruas për lidhjen tonë', historia e shantazhit në Elbasan! Në pranga 4 persona! Taksisti do merrte paratë por i dështon 'plani'
Arsen Rusta
13 Tetor, 12:52

Në Elbasan nis rehabilitimi i rrugëve në lagje, Gjiknuri dhe Llatja inspektojnë punimet
12 Tetor, 13:14

VIDEOLAJM/ Anëtarja e 'Rithemelimit' në TV e familjes Berisha: Më jepni një snajper për Ramën, ta heq nëna qafe
11 Tetor, 14:51

Kundër çmimit të naftës, Rithemelimi organizon protestën e parë në Elbasan! Boçi thirrje qytetarëve: S'ka kohë për të humbur! Qeveria do të mbulojë grabitjet
11 Tetor, 11:19

Aksident në aksin Elbasan-Belsh! 'Benz-i' përplas motoçikletën! Plagoset një 32-vjeçare
10 Tetor, 17:20



Sherr mes dy personave në qendër të Elbasanit! 54-vjeçari plagos me thikë të riun! Autori iku nga vendngjarja, por kapet nga policia
9 Tetor, 18:40



U kthyen nga emigrimi në Greqi, familja nga Belshi investon në ndërtimin e fabrikës së vajit të ullirit! Rama: Konkuron në tregun vendas dhe të huaj
9 Tetor, 16:13



Lëkundje tërmeti në Elbasan! Ja sa ishte magnituda
9 Tetor, 15:43

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje